



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 6 Nëntor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, C-203
Mbledhja filloi në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Morën pjesë: Berim Ramosaj, Gjylnaze Sylja, Adem Salihaj, Ramadan Avdiu, Adem Salihaj dhe Zylfi Merxha.

Munguan: Nait Hasani dhe Rita Hajzeraj.

Nga Departamenti Ligjor mori pjesë: Daut Beqiri, Drejtor i Departamentit

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Berim Ramosaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës

1. Konstituimi i Komisionit,
2. Propozimi për emërimin e tre anëtarëve të përhershëm të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-së
3. Të ndryshme.

1. Konstituimi i Komisionit

Kryetari i Komisionit -Duke hapur mbledhjen e parë të këtij komisioni, Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit se edhe kryetari i Kuvendit ka shprehë gatishmërinë për të marr pjesë në këtë mbledhje por për shkak të disa angazhimeve nuk ka mundur të jetë i pranishëm. Ai pastaj u uroi mirëseardhje anëtarëve të Komisionit dhe tha që shpreson që të këtë një frymë bashkëpunimi të ndërsjelle dhe përbërja e komisionit garanton që ky komision të jetë komisioni efikas. Ne mbështetje te nenit 67.6 të Kushtetues dhe nenit 6 te Rregullores se punës se Kuvendit është themeluar Komisioni për Forcën e Sigurisë se Kosovës.

Fushëveprimi i këtij komisioni është përgatitja e gjithë legjislacionit dhe dokumenteve që mbulojnë fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Ne si komision do të ndërtojmë bashkëpunim të mirë me Ministrinë e Forcës se Sigurisë, qoftë për procesin e zbatimit të ligjeve, qoftë për çështjeve tjerave. Sa i kësaj pike a dëshiron dikush ta marr fjalën.

Gjynaze Syla- Unë propozoi që komisioni duhet qysh ne mbledhjen e ardhshme të miratojë fushëveprimin e tij dhe një plan të punës se çka do të punoje komisioni në të ardhmen.

Adem Hajdaraj- Besoi që është mire ta caktohet një orar për mbajtjen e mbledhje të Komisionit apo te leme njëherë kështu. Është mirë të caktohet puna e orarit.

Adem Salihaj- Duke marr fjalën ai tha se kemi shume pune përpara. Duhet të kemi një plan të punës për mbikëqyrjen e Forcës se Sigurisë duke thirrur ne takim edhe Komandantin e Forcës se Sigurisë për tu informuar si komision për pune e kësaj force.

Ramadan Avdiu- Unë desha t'u përshëndes dhe si komision i ri që jemi ne takimin e ardhshëm ti dimë angazhimet që i kemi dhe te ndërtojmë ne bashkonim të mire me Ministrinë e Forcës se Sigurisë e nëse ka nevojë edhe me zyrtarët e Forcës së Sigurisë.

Zylfi Merxha- Ju përshëndes ju z. Kryetar dhe ju them se ky komision është komision i rëndësishme dhe me stafin që ka do të arrij sukses. z. Kryetar do të keni sukses me këtë komision se keni njerëzit e duhur në këtë komision.

Kryetari i Komisionit- Sa i për këtë mbështetjes se Komisionit mund t'u them se akoma nuk kemi staf te përhershëm. Këtë staf e kemi te përkohshëm por kemi premtim nga Kryetari i Kuvendit që komisioni do të këtë stafin e vet dhe zyrën ne mënyrë që komisioni të jetë efikas. Për te na informuar për këtë ja jap fjalën Drejtorit të Departamentit Ligjor ne Kuvend z. Daut Beqiri.

Daut Beqiri- Ju njoftoi se sipas vendit të Kuvendit çdo komisioni do të këtë stafin e vet mbështes te përbëre nga dy veta. Një koordinator dhe një zyrtar. Ky komision pritet te këtë stafin e vet mbështetës por do të këtë edhe mbështetje nga partnerët që ndihmojnë punën e Kuvendit. Sigurisht që këtij komisioni i nevojitet mbështetje nga ekspert me

përvojë nga fusha e sigurisë dhe do ta këtë mbështetje. Sa i përket fushëveprimit të Komisionit duhet që me mbledhjen e ardhshme të këtë një draft të fushëveprimit që pastaj të plotësohet nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Jemi komision i ri por shpresojmë të nderojmë një komision që punon mirë. Tani propozoj të kalojmë në piken e dytë.

2. Propozimi për emërimin e tre anëtarëve të përhershëm të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të NATO-së

Kryetari i Komisionit –Lidhur me këtë pikë ju njoftoi kemi një përfundim të Kryesisë së Kuvendit ku kërkohet që si komisioni të caktojme tre anëtarë të përhershëm për të marrë pjesë në sesionet e Asamblesë Parlamentare të NATO-së. Deri me tani kanë marrë pjesë tre anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Sllobodan Petrović, por tani kërkohet nga në Komision ta caktojme në delegacion. Një anëtar duhet të jete serb i Kosovës dhe thuhet se anëtarët delegacionit duhet të njohin një gjuhë të huaj zyrtare në Asamblesë Parlamentare dhe të kenë njohuri nga fusha e sigurisë.

Pa modesti po e them që unë si kryetar i komisionit pas disa konsultimeve që kam pasur me anëtar të kryesisë propozoi që në kuadër të këtij delegacioni të shkoj unë si kryetar i komisionit, Ramadan Avdiu dhe Sllobodan Petrović. A ka propozim tjetër.

Gjylnaze Sylja- Unë propozoj veten që të jem pjesëmarrës në këtë delegacion pasi kam bërë disa trajnime nga kjo fushë. Kam qenë në trajnim edhe në Qendren Marshall për studime të sigurisë në Gjermani. Gjithashtu e njoh edhe gjuhën angleze dhe jam e certifikuar për gjuhë angleze.

Adem Salihaj- Unë nuk po marr fjalën për ta propozuar veten por veç desha me cekë se kompozicioni i këtij delegacioni nuk është ai që mund ta përfaqësoj Kosovën sepse jeni të trete nga pozita. Sa për informim tuajin unë jam ushtarak jam me grade major.

Zylfi Merxha- Kryetar i nderuar unë si di pse këta njerëz duhet të shkojnë përherë. Është mirë të respektohet rregulli që ti jepet mundësi të shkojnë edhe të tjerë. Unë nuk jam ushtarak por jam qytetarë i këtij vendi. Unë si deputet çdo herë kam ardhur në mbledhje të komisionit. A disa deputet nuk vijë gati kurrë në mbledhje. Për atë unë propozoi që nëse ka qenë dikush atëherë mund të propozohet ndonjë deputet tjetër.

Kryetari i Komisionit- Sa i përket përbërjes së delegacionit veç po ju informoi se Asambleja Parlamentare e NATO-s dhe jo kryesia e kuvendit ka vendosë që një pjesëtar të jete nga komuniteti serb.

Ramadan Avdiu – Unë konsideroj se gjithsesi duhet të jetë pjesë e delegacionit një anëtarë i grupit më të madh parlamentar në Asamblesë parlamentare të NATO-s.

Adem Salihaj – Çështja e FSK-së është mjaft e rëndësishme dhe unë mendoj se nuk duhet të merret ekskluzivisht pozita apo opozita.

Kryetari i Komisionit – Këtu kemi dy propozime në lidhje me këtë çështje, propozimi im dhe ai i Gjylnazes. Duke pasur parasysh që nuk po arrihet një konsensus unë e hedh në votim.

Adem Salihaj - Unë mendoj se është e dobishme të kemi një konsultim ne partitë në mes veti dhe po ashtu konsultim me Kryesinë e Kuvendit.

Kryetari i Komisionit – Në bazë të sugjerimeve aty nuk është e cekur se kush merr pjesë, opozita apo pozita, veç të jenë deputet të Kuvendit të Kosovës.

Gjylnaze Sylja - Përfaqësimi për në Asamblenë Parlamentare të NATO-s duke marr parasysh propozimin e juaj, bëhet nga koalicioni dhe nuk mendoj se është e arsyeshme të shkojnë përfaqësuesit që janë në pushtet.

Zylfi Merxha – Mendoj se duhet të marr pjesë Kryetari i Komisionit, Slobodan Petrovič pasi është vetëm si kusht që të marr pjesë dhe një të caktohet duke votuar.

Kryetari i Komisionit – Propozim është Berim Ramosaj, Ramadan Avdiu, Gjylnaze Sylja dhe Adem Salihaj. Secili të voton dhe nga ky propozim të zgjedhën tre deputet që do të jenë pjesë e delegacionit. Kush voton për Berim Ramosaj për anëtarë në Asamblenë Parlamentare të NATO-s? Katër vota janë pro dhe dy kundër. Dhe vazhdon votimi për Ramadan Avdiun 3 pro dhe 3 kundër. Ndërsa Gjylnaze Sylja bashkë me Adem Salihaj lëshon mbledhjen e Komisionit me arsye se procedura e përzgjedhjes nuk është duke u bërë në rregull.

Pjesë e delegacionit që u zgjedhën për të marr pjesë në Asamblenë Parlamentare të NATO-s janë: Berim Ramosaj, Slobodan Petrovič dhe Ramadan Avdiu.

3. Të ndryshme

Pasi që nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 11.00

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit
Berim Ramosaj